



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**VENDIM**

**K.P.P. 843/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|               |            |
|---------------|------------|
| Evis Shurdha  | Kryetar    |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj  | Anëtar     |
| Lindita Skeja | Anëtar     |
| Merita Zeqaj  | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 14.12.2018, shqyrtoi ankesat me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k., “Nelsa” sh.p.k. dhe “Alar Food & Service” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me objekt, “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Universitar Obsterik-Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”*”, me nr. REF-87792-09-28-2018, me fond limit 4,069,505 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 11.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Sori-Al” sh.p.k.  
*Adresa: Rr. “Beqir Luga”, P.3, Shk.1/1, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara  
*Adresa: Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë.*

**Baza Ligjore:** *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 01.10.2018 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me objekt, “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Universitar Obsterik-Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, me nr. REF-87792-09-28-2018, me fond limit 4,069,505 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 11.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2 Në datën 11.10.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 16.10.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku rezulton si më poshtë vijon:\

|                               |                    |              |
|-------------------------------|--------------------|--------------|
| 1. ”Dajti Park 2007” shpk     | 2,931,391.00 lekë, | Kualifikuar; |
| 2. ”Nelsa” shpk               | 3,183,266.00 lekë, | Kualifikuar; |
| 3. ”Alar Food & Service” shpk | 3,206,770.00 lekë, | Kualifikuar; |
| 4. ”Sori-Al” shpk             | 4,066,615.38 lekë, | Kualifikuar; |

II.4.Në datën 22.10.2018 operatori ekonomik ankimues "Sori-Al" sh.p.k ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik "Dajti Park 2007" sh.p.k., "Nelsa" sh.p.k. dhe "Alar Food & Service" sh.p.k.

II.5. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 1079/1 Prot. datë 29.10.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "Sori-Al" sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën.

II.6.Në datën 07.11.2018 operatori ekonomik ankimues "Sori-Al" sh.p.k ka paraqitur për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, në të cilën argumenton si më poshtë vijon:

*"[...]Kualifikimi i Shoqërisë "DAJTI PARK 2007" Sh.p.k është i parregullt dhe në shkelje të ligjit duke Ju argumentuar si më poshtë vijon:*

*1. Ofertuesi nuk plotëson pikën 4, tek seksioni 3.3 Kapaciteti Teknik, në Kriteret e Vecanta për Kualifikimit të DST, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që të provojë se disponon ambientin për të ushtruar veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit në pronësi ose të marrë me qera.*

*2. Nuk ka paraqitur dokumentacion që të provojë se të punësuarit (mercollog/kuzhinierë/ndihmës-kuzhinierë) janë të pajisur me librezë pune të vlefshme. Prandaj ofertuesi nuk plotëson një nga kriteret e përcaktuar në pikën 8 të seksionit 3.3 Kapaciteti Teknik, në Kriteret e Vecanta për Kualifikim të DST.*

*3. Listpagesat e dorëzuara nga ofertuesi nuk janë të vulosura nga administrata tatimore për të gjithë periudhën e kërkuar sipas në pikës 6 të seksionit 3.3 Kapaciteti Teknik.*

*4. Nuk plotëson kriterin e veçantë për: "Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri".*

*Kualifikimi i Shoqërisë "NELSA" Sh.p.k është i parregullt dhe në shkelje të ligjit duke Ju argumentuar si më poshtë vijon:*

*1. Operatori ekonomik "NELSA" Sh.p.k nuk plotëson kriterin për liçencë profesionale të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit me objekt përpunim dhe shpërndarje ushqimi bazuar ky pretendim në lejet dhe liçencat aktive të subjektit të publikuara në regjistrin zyrtar të Qendrës Kombëtare të Liçencimit.*

*2. Nuk plotëson pikën 2 dhe 3, të seksionit 3.3 Kapaciteti teknik në Kriteret e Vecanta për Kualifikimit të DST, për dorëzimin e certifikave ISO 9001-2015 dhe ISO 22000:2005; të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.*

*3.Ofertuesi nuk plotëson pikën 5, tek seksioni 3.3 Kapaciteti Teknik, në Kriteret e Vecanta për Kualifikimit të DST, pasi nuk disponon një mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore në pronësi apo të marrë me qira.*

*4.Nuk plotëson kriterin teknik, pika 8, për numrin e të punësuarve në sektorin e shërbimit të gatimit për periudhën e kërkuar (ndihmës kuzhinier/ shërbyes gatimi).*

*5.Ofertuesi nuk ka paraqitur dokumentacionin shoqërues të kërkuar sipas profesioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht të pikës 8, seksioni 3.3, të Krieteve të Veçanta të Kualifikimit.*

*Kualifikimi i Shoqërisë "Alar Food & Service" Sh.p.k është i parregullt dhe në shkelje të ligjit duke Ju argumentuar si më poshtë vijon:*

*1. Nuk ka paraqitur vërtetim debie OSHEE për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë (vërtetimi i dorëzuar është për një tjetër shoqëri). Nuk është hera e parë që ky operator ekonomik dorëzon një vërtetim debie të OSHEE në emërin e një Shoqërie tjetër me justifikimin që ka nënshkruar një kontratë qeraje me këtë shoqëri. Njëkohësisht edhe Autoriteti Kontraktorë nuk mund ta konsiderojë të vlefshëm një vërtetim të tillë me pretendimin që është lidhur një kontratë qeraje dhe për rrjedhojë vërtetimi është i vlefshëm, për arsye se: Së pari: Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, Neni 28 "Kontratat e shërbimeve", pika 4, shkronja (ç) kërkohet: një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pese) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. Pra, në referim të VKM-së së sipërpërmendur, është detyrim i Operatorit Ekonomik të dorëzojë vërtetim debie në emër të subjektit të vet dhe jo në emër të një subjekti tjetër. Së dyti. Bazuar në të dhënat e Qendrës Kombëtare të Biznesit Shoqëria "Alar Food & Service" Sh.p.k ushtron aktivitetin e saj në adresat mëposhtme: -Tiranë, Rruga "Lord Bajron", Laprakë Brenda ambjenteve të Spitalit Amerikan Nr.1, ZK 8310, Nr. 5/14, vol 20 fq 213; -Tiranë, Njësia administrative Nr. 6, Rruga "Sabaudin Gabrani" brenda ambjenteve të Spitalit Amerikan 3, Godina B;-Tiranë Rruga e "Dibrës", brenda ambjenteve të Spitalit Amerikan Nr.2, ZK 8120, RH 102/15 Vol 16 fq. 226. Një kontratë qeraje e lidhur për një ambjent të vetëm, nuk legjitimon shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike edhe për gjithë adresat e tjera sekondare ku ushtron veprimtarinë Operatori Ekonomik sic kërkohet në kriterin e përcaktuar në shkronjën (d) të seksionit 2 Kriteret e Vecanta për Kualifikimit të DST.*

*2. Bazuar në të dhënat e Qendrës Kombëtare të Biznesit, poseduesi i kuotave të shoqërisë "Alar Food & Service" Sh.p.k. ka lidhur Kontratë Pengu Nr. 2650 Rep/ Nr. 1184 Kol datë 23.06.2015 mbi kuotat e pjesmarrjes në shoqëri me Raiffeisen Bank në përmbushje të detyrimeve të Kontratës së Kredisë Bankare Nr. 2648 Rep/ Nr. 1182 Kol, datë 23.06.2015. Vendosja e kuotave të kapitalit të shoqërisë si garanci për zbatimin e kontratës së kredisë bankare, cënon sigurinë e subjektit (operatorit ekonomik) për të ofruar qëndrueshmëri dhe vijimësi në përmbushjen e objektit të kontratës me Autoritetin Kontraktor, në rastin e shpalljes fitues.*

*3. Ofertuesi nuk ka paraqitur dokumentacionin shoqërues për të nevojshëm për të vërtetuar që në ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit është i pajisur me Lejen e mjedisit të tipit C, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit QKB.*

*4. Nuk plotëson kriterin teknik të numrit të të punësuarve në sektorin e shërbimit të gatimit për periudhën e kërkuar sipas pikës 6. Dokumentacioni i dorëzuar mbi punonjësit e kërkuar në pikën 8 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor. [...]"*

II.7.Në datën 20.11.2018, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1169/1prot., datë 19.11.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues,

#### **Arsyeton:**

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Sori-Al" sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik "Dajti Park 2007" sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin : *"1. Ofertuesi nuk plotëson pikën 4, tek seksioni 3.3 Kapaciteti Teknik, në Kriteret e Vecanta për Kualifikimit të DST, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që të provojë se disponon ambientin për të ushtruar veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit në pronësi ose të marrë me qera."*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në pikën 3.3.4 të shtojcës 7, "Kapaciteti teknik", në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*"Operatori ekonomik duhet të disponojë ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit. Per te plotesuar kete pike operatori ekonomike duhet te paraqese:*

*-Dokumentacionin qe verteton pronesine ose marrjen me qera te ketij ambienti.*

*-Leje e mjedisit e tipit C, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) per zhvillimin e aktivitetit të gatimit dhe shperndarjes se ushqimit, per objektin ne fjale.*

*-Leje higjeno - sanitare per objektin ne fjale.*

*-Aktin Teknik persa i perket masave mbrojtese te zjarrit"*

III.1.2.Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik "Dajti Park 2007" sh.p.k. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

- Certifikatë Pronësie, kartelë pronësie dhe harta treguese e regjistrimit, e pronës me nr.pasurie 18/89, Vol.11, fq.42, ZK. 3051, me adresë Priskë e Madhe, Tiranë, në pronësi të Shoqërisë "Vllaznia" sh.p.k,
- Akt-miratimi higjeno-sanitar nr.127, datë 06.02.2017, lëshuar për subjektin "Dajti Park 2007" sh.p.k., për aktivitetin Bar-Restorant-Hotel-Pishinë, në adresën nr.pasurie 18/89, rruga kombëtare Tiranë-Dajt.
- Certifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, nr.D-21153/1prot., datë 27.08.2018, lëshuar për subjektin "Dajti Park 2007" sh.p.k., për objektin Bar-Restorant-Hotel, me adresë Priskë e Madhe, Tiranë.
- Leje mjedisi e tipit C, lëshuar nga QKB, për subjektin "Dajti Park 2007" sh.p.k., për veprimtarinë Furra të prodhimit të bukës. Gatimi dhe tregëtimi i produkteve ushqimore të gatshme dhe gjysmë të gatshme. Magazinimi frigoriferik i produkteve ushqimore të ambalazuara.

III.1.3.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.1.4.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ”Dajti Park 2007” sh.p.k., në mënyrë elektronike, KPP konstaton se, në përmbushje të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit objekt shqyrtimi, operatori ekonomik ”Dajti Park 2007” sh.p.k. ka paraqitur Certifikatë Pronësie, kartelë pronësie dhe hartën treguese të regjistrimit, të pronës me nr.pasurie 18/89, Vol.11, fq.42, ZK. 3051, me adresë Priskë e Madhe, Tiranë, në pronësi të Shoqërisë “Vllaznia” sh.p.k. (nga verifikimi subjekti “Vllaznia” sh.p.k. është e njëjtë me subjektin ”Dajti Park 2007” sh.p.k.), shoqëruar me akt-miratim higjeno-sanitar, certifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin dhe leje mjedisore e tipit C, lëshuar për aktivitein Bar-Restaurant-Hotel, në adresën Priskë e Madhe. Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkretë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ”Dajti Park 2007” sh.p.k. e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor pikën 3.3.4 të shtojcës 7, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi me anë të këtij dokumentacioni arrin të vërtetojë se disponon ambjentin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit të ushqimit me të gjithë elementët sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ”Sori-Al” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin : *“2.Nuk ka paraqitur dokumentacion që të provojë se të punësuarit (mercollog /kuzhinierë /ndihmës-kuzhinierë) janë të pajisur me librezë pune të vlefshme. Prandaj ofertuesi nuk plotëson një nga kriteret e përcaktuar në pikën 8 të seksionit 3.3 Kapaciteti Teknik, në Kriteret e Vecanta për Kualifikim të DS”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në pikat 3.3.7 dhe 3.3.8 të shtojcës 7, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*“7.Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjes me profesione si ne tabelën e mëposhtme:*

| <i>Nr.</i> | <i>Profesioni</i>                         | <i>Numri i punonjesve</i> |
|------------|---|---------------------------|
| <i>1</i>   | <i>Kuzhinier</i>                          | <i>1</i>                  |
| <i>2</i>   | <i>Mercollog/Kimist/teknolog</i>          | <i>1</i>                  |
| <i>3</i>   | <i>Ndihmes kuzhinierë/Shërbyes gatimi</i> | <i>2</i>                  |
|            | <b><i>Total</i></b>                       | <b><i>4</i></b>           |

8. Punonjësit në tabelën e mësipërme duhet të kenë minimalisht 1 vit eksperiencë pune dhe të paraqesin dokumentacionin sipas profesioneve si më poshtë:

a) Për kuzhinierin: diplome ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, kopje të librezës së punës dhe librezën shëndetsore.

b) Për mercollogun/kimistin/teknologun: diplomë ose certifikatë kualifikimi, kontrate pune, kopje të librezës së punës dhe librezën shëndetsore.

c) Për ndihmës kuzhinierë/Sherbyes gatimi: kontratë pune, kopje të librezës së punës dhe librezën shëndetsore”

III.2.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik ”Dajti Park 2007” sh.p.k. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

- 3 (tre) Kontrata individuale pune të lidhura ndërmjet subjektit ”Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe punonjësve Kuzhinier, shoqëruar me librezat e punës, librezat shëndetësore dhe certifikatat profesionale përkatëse për punonjëset Xh.Q., E.K. dhe Sh.Q.
- 4 (katër) Kontrata individuale pune të lidhura ndërmjet subjektit ”Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe punonjësve Nd/Kuzhinier, shoqëruar me librezat e punës dhe librezat shëndetësore përkatëse për punonjëset E.P., R.Z., S.B. dhe M.M.
- Kontratë individuale pune të lidhura ndërmjet subjektit ”Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe punonjësit Teknolog Ushqimor, shoqëruar me librezën e punës librezën shëndetësore, certifikatë profesionale dhe CV përkatëse, për punonjësin F.S.

III.2.3. Në nenin 46., të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.2.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.2.5.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Dajti Park 2007" sh.p.k., në mënyrë elektronike, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, KPP konstaton se librezat e punës të paraqitura, për punonjëset Kuzhinier Xh.Q., E.K. dhe Sh.Q., për punonjëset Nd/Kuzhinier, E.P., R.Z., S.B. dhe M.M dhe punonjësin Teknolog Ushqimor F.S. janë të punonjësve për të cilët janë paraqitur kontratat e punës dhe cdo dokument tjetër i kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Gjithashtu, këto libreza përmbajnë datën e fillimit të punës, firmën e administratorit të shoqërisë dhe vulën e saj, si dhe llojin e punësimit, i cili përputhet me atë të përcaktuar në kontratën individuale të punës, duke përmbushur cdo kriter vlefshmërie që mund të përmbajë një librezë pune. Në këto kushte, Komisioni gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Dajti Park 2007" sh.p.k., për të cilat ngre pretendime ankimesi, është i rregullt dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimesi nuk qëndron.

III.3.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "Sori-Al" sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik "Dajti Park 2007" sh.p.k." sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin : *"3. Listpagesat e dorëzuara nga ofertuesi nuk janë të vulosura nga administrata tatimore për të gjithë periudhën e kërkuar sipas në pikës 6 të seksionit 3.3 Kapaciteti Teknik", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1.Në pikën 3.3.6 të shtojcës 7, "Kapaciteti teknik", në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:  
*"6.Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 4 (katër) persona të punësuar në sektorin e shërbimit të gatimit, të siguruar për periudhën qershor 2018 – gusht 2018. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë: •Një vertetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për periudhën qershor 2018 – gusht 2018. •Listepagesat (E-Sig 025) të vulosura nga Administrata Tatimore për periudhën qershor 2018 – gusht 2018."*

III.3.2. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" parashikohet shprehimisht: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."*

III.3.3.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), në përmbushje të kriterit të mësipërm, nga operatori ekonomik "Dajti Park 2007" sh.p.k., konstatohet se janë paraqitur listepagesat e shoqërisë "Dajti park 2007" sh.p.k. të periudhës Janar 2018 – Gusht 2018, të konfirmuara (me shkresë përcjellëse) dhe të vulosura në cdo fletë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në këto kushte, Komisioni gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Dajti Park 2007" sh.p.k., për të cilat ngre pretendime ankimesi, është i rregullt dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në pikën 3.3.6 të shtojcës 7, "Kapaciteti teknik" në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimesi nuk qëndron.



III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "Sori-Al" sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik "Dajti Park 2007" sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin : "4. Nuk plotëson kriterin e veçantë për: "Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në pikën 2.d të shtojcës 7, "Kriteret e vecanta të kualifikimit", në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*"d. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri."*

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike për operatorin ekonomik "Dajti Park 2007" sh.p.k, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ky i fundit ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim debie" nr. 7990 prot, datë 25.09.2018, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuesit Desart Kalaja, përfaqësues ligjor i shoqërisë "Dajti Park 2007" sh.p.k, ku evidentohet që nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për 8 kontrata; titullar dhe përdorues i të cilave është "Dajti Park 2007" sh.p.k rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 25.09.2018, duke përfshirë faturën koherente të muajit Gusht 2018.

III.4.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" parashikohet shprehimisht: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."* Ndërsa neni 53, pika 3 përcakton: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji."*

III.4.4. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), në datën 15.06.2015, është protokolluar shkresa e OSHEE-së me nr. 1081/1 prot., me objekt: *"Kthim përgjigje kërkesës për informacion"*, drejtuar Komisionit të i Prokurimit Publik, në të cilin jepet informacioni si më poshtë:

*"[...] Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkues të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë:*

1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara).
2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuara si private.
3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përveç rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira. Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familiare, Operatori i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimit bazuar në

*legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë operatorët që kërkojnë të pajisen me Vërtetimin e Debisë duhet të aplikojnë pranë Qendrave të KNK në të gjithë Shqipërinë dhe lëshimi do të jetë i mundur jo më vonë se pesë ditë pas kërkesës nga subjekti. Mosplotësimi i kriterëve të mësipërme do të rezultojë me moslëshimin e Vërtetimit të Debisë nga Drejtoria Qëndrore ose Drejtoritë Rajonale. Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur:*

- 1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit.*
- 2. Konsumatori rezulton debitor.*
- 3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.*
- 4. konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.*
- 5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë.[...]*

III.4.5. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” shpk ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike një vërtetim, sipas formatit të miratuar, me anë të së cilës vërtetohet se subjekti “Dajti Park 2007” shpk nuk rezulton debitor për kontratat e sipërcituara, përfshirë edhe muajin Gusht 2018. KPP gjykon se Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Sh.a është institucioni i ngarkuar me akt nënligjor për lëshimin e vërtetimit të debisë për personat fizikë dhe juridikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.a., këtu e në vijim (OSHEE Sh.a), nr. 1081/1 prot., me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës për informacion”, për dijeni Komisionit të i Prokurimit Publik, OSHEE sh.a. ndër të tjera sqaron se: “*Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur: 1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit. 2. Konsumatori rezulton debitor. 3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste. 4. Konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së. 5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë.* KPP gjykon se institucioni i OSHEE-së menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike për të gjithë kontratat e lidhura midis OSHEE-së dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Sori-Al” sh.p.k. ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomik “Nelsa” sh.p.k. dhe “Alar Food & Service” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shlyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.a. përmbush kriteret e kualifikimit për të cilat ngre pretendime ankimuesi dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomik “Nelsa” sh.p.k. dhe “Alar Food & Service” sh.p.k., nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt

prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar. Për këtë arsye këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sori-Al” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*”, me objekt, “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Universitar Obsterik-Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”*”, me nr. REF-87792-09-28-2018, me fond limit 4,069,505 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 11.10.2018, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1702 protokoli Datë 07.11.2018**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**